FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA
BASKETBALL FEDERATION OF KOSOVO
Nr. 603 Dt. 04.10.2019
PRISHTINË • PRIŠTINA • PRISTINA

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

## VENDIM I BORDIT TË FBK-SË, DATA 04.10.2019, Prishtinë

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) sot ka marr vendim që të vazhdojë t'i shpërblejë klubet e Superligës së Kosovës dhe Superligës së Femrave për rezultatet e arritura në edicionin 2019/20.

Por që kësaj radhe risia është se Bordi i FBK-së ka vendosur ta shtojë edhe një fond të shpërblimeve për Superligën e Kosovës konform Rregullores mbi të Drejtat dhe Transmetimet Audio Vizuale, e që ky fond është siguruar nga të hyrat nga të drejtat audio vizuale të Superligës së Kosovës, më saktësisht nga partneri medial i FBK-së, kompania ART MOTION, me të cilin FBK ka bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe me të cilin kanë hyrë në vitin e dytë të bashkëpunimit.

Nga fondi i shpërblimeve të FBK-së skuadra kampione e elitës së basketbollit kosovar do të vazhdojë të shpërblehet me 12,000.00 euro, ndërsa ekipit nënkampion do ti takojnë 6,000.00 euro.

Skuadrat që do të arrijnë të sigurojnë nga një vend në katërshen e madhe të elitës së basketbollit kosovar do të shpërblehen me nga 3,000.00 euro.

Skuadra kampione në Superligën e Femrave do të shpërblehet me shumën 4,000.00 euro.

Ndërkaq nga fondi i të hyrave nga të drejtat audio vizuale të Superligës së Kosovës, pra nga partneri medial i FBK-së, kompania ART MOTION, secilit klub të elitës së basketbollit kosovar (gjithsej 9) do ti takojnë nga 2,000.00 Euro, ndërsa për skuadrat pjesëmarrëse në play-off ndarja do të jetë:

1. 8,000.00 EURO (vendi i parë);

2. 4,000.00 EURO (vendi i dytë);



TEB ART RUGOVE IP bakertilly Spitali Amerikan kutia

3. 2,000.00 EURO (vendi i tretë);

4. 2,000.00 EURO (vendi i katërt).

Sinqerisht,

Arben Fetahu

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës